



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 07, DATË 31.01.2025

“PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR 86, DATË 12.12.2024 “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT AFATMESËM 2025-2027 DHE BUXHETIT VJETOR 2025”.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 31.01.2025 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur “Për një shtesë në Vendimin nr 86, datë 12.12.2024 “Për miratimin e programit afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025”. Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, Udhëzimin nr 09, datë 23.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, “Për një ndryshim në vendimin nr 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e programit afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024”, i ndryshuar.

VENDOSI:

1. Të miratojë shtesën në vendimin nr 86, datë 12.12.2024 “Për miratimin e programit afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025” si mëposhtë:
Programi AB115 Kap 05, Art 602 kod produkti V043AAJ ‘Askush të mos mbetet pas’ në shumën 1,446,632 lekë.

a) Aktiviteti 2.1 Zyra e lëvizshme e-Albania, pagesa për materiale dhe ID	139,200 lekë
b) Aktiviteti 2.1 Zyra e lëvizshme e-Albania, pagesa për transportin	17,500 lekë
c) Aktiviteti 2.2 Lehtësimi i shërbimeve sociale përmes mediatorit komonitar Rom, pagesë për mediatorin	217,482 lekë
d) Aktiviteti 2.3 Aktiviteti në kuadër të Vitit të Ri, shpenzime katering	32,400 lekë
e) Aktiviteti 2.3 Aktiviteti në kuadër të Vitit të Ri, lodra për të mitur	65,000 lekë
f) Aktiviteti 2.3 Aktiviteti në kuadër të Vitit të Ri, paketa ushqimore	598,080 lekë
g) Aktiviteti 2.4 Ofrimi i kurseve profesionale, praktikë punësimi part time	240,000 lekë
h) Aktiviteti 2.5 Mundësimi i kujdesit shëndetësor për të miturit rom me nevoja të vecanta, pagesa për shërbimin shëndetësor	136,970 lekë
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretar i Këshillit
Etleva Yzo

KRYETARI I KËSHILLIT

Merita Isaraj